



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

6391/
Nr. ... Prot.
2

Tiranë, më 19.11.2012

URDHËR

Nr. 567, datë 19.11.2012

“PËR

**HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË, NË
UNIVERSITETIN PRIVAT “UNIVERSITETI I NEW YORK-UT NË TIRANË
(UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA)”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26/1.3.1, dhe të nenit 42/1, të ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 11.07.2012 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të emërimit të institucionit privat të arsimit të lartë “New York University of Tirana”,

URDHËROJ:

- I. Hapjen, në përputhje me vendimin e Këshillit të Akreditimit nr. 316, datë 16.03.2012 dhe vendimin nr. 329, datë 08.06.2012 (bashkëlidhur këtij urdhri), të programeve të studimit të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin privat “Universiteti i New York-ut në Tiranë (University of New York, Tirana)”, në:
 1. Administrim Biznesi, me profile: Shkenca Ekonomike; Financë; Menaxhim; Marketing; Kontabilitet; Biznes Ndërkombëtar;
 2. Shkenca Kompjuterike, me profile: Shkenca kompjuterike; Sisteme menaxhimi informacioni;
 3. Shkenca Shoqërore dhe Humane, me profile: Edukim; Drejtësi; Shkenca Politike/Marrëdhënie ndërkombëtare.
- II. Programet e studimit të përcaktuara në pikën I të këtij Urdhri zgjasin së paku 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike, nga të cilat së paku 15 kredite

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 2225678. Fax : +355 4 2232002


Web site: www.mash.gov.al


teorike realizohen nga pedagogë të huaj me kualifikimin akademik të kërkuar për studimet e ciklit të tretë. Në përfundim të programeve të studimit të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr.).

- III. "Universiteti i New York-ut në Tiranë (University of New York, Tirana)", do të realizojë këto programe studimi në bashkëpunim me Universitetin e Boltonit (University of Bolton), Mbretëri e Bashkuar, sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur ndërmjet këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë.
- IV. Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, të jenë në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 21 datë 30.07.2009 "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar.
- V. Studentët e programeve të studimit të doktoratës pajisen me numër individual matrikulimi (NIM) sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Provimeve gjeneron NIM vetëm pas verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të pikës IV të këtij urdhri nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.
- VI. Programet e studimit të përcaktuara në pikën I të këtij urdhri të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2012-2013.
- VII. Universiteti privat "Universiteti i New York-ut në Tiranë (University of New York, Tirana)" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit brenda vitit akademik 2013-2014.
- VIII. Ngarkohet Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për kontrollin periodik për zbatimin e standarteve akademike dhe të kërkimit shkencor sipas legjislacionit në fuqi.
- IX. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.
- X. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Zëvendësministri për arsimin e lartë, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i New York-ut në Tiranë (University of New York, Tirana).

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MYQEREM TAJAJ


MINISTËR



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 2225678. Fax : +355 4 2232002

Web site: www.mash.gov.al